

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237,
ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL – OBILIQ

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit 614-26-4613-1-2-1

Nr i brendshëm

Sa i përket tenderit për “Furnizimi me Dru dhe Pelet në të gjitha Insitucionet Edukativo Arsimore, Kulturore dhe Shëndetësore në Komunën e Obiliqit”

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“FENIKS-A” SH.P.K

Shkelqim Shabanaj, Dobrixhe, Gjakove Republika e Kosovës

GJAKOVË

50000

+383 49 674 911

Armend Shabanaj

feniks.a.group@gmail.com

09/07/2026



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtoj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Aktiviteti i prokurimit “Furnizimi me Dru dhe Pelet në të gjitha Insitucionet Edukativo Arsimore, Kulturore dhe Shëndetësore në Komunën e Obiliqit”, me nr. të prokurimit 614-26-4613-1-2-1 është publikuar me datë 12.06.2026 në eprokurim.

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve është 02/07/2026 në ora 10:00.

Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

Vendimi ne kërkesën per rishqyrtim 29/06/2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Aktiviteti i prokurimit është në proces të ofertimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK KOMUNA E OBILIQIT nuk e ka respektuar Ligjin për Prokurimi Publik dhe Rregulloren për Prokurim Publik në nenet në vijim:

- Neni 1 Qëllimi;
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur;
- Neni 27 Dosja e Tenderit;
- Neni 28 Specifikimet teknike;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqjen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Bazuar në nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me Dru dhe Pelet në të gjitha Insitucionet Edukativo Arsimore, Kultureore dhe Shëndetësore në Komunën e Obiliqit”**, me nr. të prokurimit 614-26-4613-1-2-1, të iniciuar nga Komuna e Obiliqit.

Operatori Ekonomik “FENIKS-A” SH.P.K konsideron se në aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me Dru dhe Pelet në të gjitha Insitucionet Edukativo Arsimore, Kultureore dhe Shëndetësore në Komunën e Obiliqit”**, me nr. të prokurimit 614-26-4613-1-2-1 janë përdorur kritere jo objektive dhe të paqarta në Dosjen e Tenderit, si:

I. Mungesa e sasive të planifikuara për dru dhe pelet

Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar sasi të planifikuara për furnizimin me dru dhe pelet, ndonëse bëhet fjalë për një aktivitet të përsëritur vjetor dhe nevojat reale të institucioneve (shkollave) janë të njohura dhe të matshme në bazë të konsumit të viteve paraprake.

Në formularin e çmimeve është vendosur sasia “1” për secilin artikull, ndërsa vlerësimi i ofertave është bazuar në peshën 70% për dru dhe 30% për pelet, pa asnjë bazë objektive, statistikore apo teknike që të justifikojë këtë ndarje.

Kjo qasje është problematike sepse:

- druri dhe peleti janë produkte me karakteristika të ndryshme teknike dhe ekonomike;
- kanë struktura të ndryshme çmimi në treg;
- ndikohen nga faktorë të ndryshëm të furnizimit, përpunimit dhe transportit.

Si rezultat, çmimi për metër dru dhe çmimi për ton pelet nuk janë të krahasueshëm dhe nuk mund të trajtohen me të njëjtën metodologji vlerësimi pa përcaktim të sasive reale.

Mungesa e sasive të planifikuara i pamundëson operatorëve ekonomikë:

- të llogarisin koston reale të kontratës;
- të vendosin çmime reale; dhe
- të përgatisin oferta të krahasueshme dhe transparente.

Nëse Autoriteti Kontraktues do të kishte përcaktuar sasi të planifikuara për secilin produkt, bazuar në konsumin e viteve paraprake dhe nevojat institucionale, konkurrenca do të zhvillohej mbi baza të njëjta dhe objektive.

Në mungesë të këtyre të dhënave ekziston rreziku që procedura të mos rezultojë në përdorim efikas dhe ekonomik të parasë publike për qëllimin e saj të dedikuar.

Për më tepër, në praktikën e zakonshme të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës, në procedurat e furnizimit me dru dhe pelet zakonisht përcaktohen sasitë e planifikuara për secilin produkt.

Komuna e Obiliqit, pa dhënë arsytim në dosjen e tenderit për këtë devijim nga praktika e zakonshme, ka cenuar parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

II. Kriteri “Kapaciteti teknik dhe profesional” – kërkesa nr. 1 është i paqartë, joproportional dhe kufizon konkurrencën

Në Dosjen e Tenderit, tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar që “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar furnizime të njëjta në tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 150,000.00 €.”

Ky kriter është i paqartë, jo objektiv dhe nuk është hartuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për këto arsye:

- Komuna e Obiliqit nuk ka sqaruar se çfarë nënkuptohet me termin “furnizime të njëjta”, duke lënë paqartësi nëse kërkohet përvojë në furnizim me dru, pelet, apo domosdoshmërisht me të dy produktet së bashku.
- Kjo paqartësi krijon mundësi për interpretim subjektiv gjatë vlerësimit dhe rrit rrezikun e diskriminimit të operatorëve ekonomikë.
- Një operator ekonomik mund të ketë përvojë të konsiderueshme në furnizimin me dru ose vetëm me pelet dhe megjithatë të ketë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës.

Kërkesa e formuluar në këtë mënyrë mund të përjashtojë operatorë ekonomikë të kualifikuar pa arsye objektive, duke kufizuar konkurrencën dhe duke cenuar trajtimin e barabartë.

Për këto arsye, kërkohet që Komuna e Obiliqit të:

- përcaktojë qartë sasitë e planifikuara për furnizim me dru dhe për furnizim me pelet; dhe
- të sqarojë në mënyrë të detajuar se çfarë konsiderohet “furnizim i njëjtë”, si dhe të specifikojë ndarjen e vlerave të furnizimeve me dru dhe pelet në furnizimet e viteve të kaluara.

Ky kriter është korrigjuar pas kërkesës për rishqyrtim.

Bazuar faktet e paraqitura më lartë për trajtimin e padrejtë të OE “FENIKS-A” SH.P.K kërkojmë nga OSHP_ja që të merret:

VENDIM

- I. **APROVOHET** e bazuar kërkesa për rishqyrtim e **OE “FENIKS -A” SH.P.K**, dhe
- II. **KORIGJOHEN**, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, formulari i çmimeve dhe të harmonizohen me qëllimin dhe lëndën e prokurimit, duke shmangur çdo paqartësi që mund të ndikojë në kufizimin e konkurrencës, në interpretim subjektiv gjatë vlerësimit ose në pamundësimin e ofertimit të drejtë dhe të barabartë nga operatorët ekonomikë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Diskualifikimi i një operatori ekonomik nga procedura e prokurimit për shkak të mungesës së përmbushjes së kriterëve të përzgjedhjes, të cilat nuk janë proporcionale me objektin e

kontratës, shkakton dëme materiale të drejtpërdrejta për OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit.

Këto dëme materiale lidhen kryesisht me:

- humbjen e fitimit të pritur nga kontrata;
- shpenzimet e pakthyeshme të ofertimit; dhe
- humbjen e mundësive për kontrata të ardhshme, si pasojë e përjashtimit nga konkurrenca për një kriter që nuk reflekton domosdoshmërisht aftësinë reale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”;
- b) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve;
- c) një kopje të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.